



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VORË

NJOFTIM

APLIKIME PËR BURSE

Në mbështetje të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar, për vitin shkollor 2025–2026, Bashkia Vorë njofton të gjithë nxënësit që ndjekin arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë në institucionet arsimore publike, se do të përfitojnë bursë në përputhje me kuotat dhe kriteret e vendosura nga qeveria.

Kategoritë përfituese sipas pikës 2.3 të VKM-së janë:

- a) Nxënësit me statusin e jetimit;
- b) Nxënësit që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë;
- c) Nxënësit që gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, si dhe nxënësit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga komisioni mjeko-ligjor;
- ç) Nxënës me statusin ligjor që nuk dëgjojnë ose nuk shikojnë;
- d) Nxënës, fëmijë të personave që gëzojnë statusin e invalidit;
- e) Nxënës të identifikuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe që kanë humbur kujdesin prindëror;
- ë) Nxënës, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, Forcave të Armatosura, Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Policisë së Burgjeve, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;
- g) Nxënësit me një prind, ku njëri prej prindërve nuk jeton.

SQAROHET SE:

Nxënësit e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të saj kur:

- a) Janë ndarë nga trangu familjar;
- b) Familja e tyre ushtron veprimtari private;
- c) Janë shpallur mbetës apo përsëritës dhe kanë humbur vitin shkollor për arsye të rezultateve jo kaluese;
- ç) Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të njësuara me origjinalin;
- d) Afati i lëshimit të dokumenteve duhet të jetë brenda muajit të fundit në të cilin kryhet aplikimi.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 19 dhjetor 2025.

Dokumentacioni do të dorëzohet nga vetë institucionet arsimore (shkollat) pranë Drejtorisë së Arsimit dhe Shërbimeve Sociale në Bashkinë Vorë.

Për çdo informacion shtesë, qytetarët mund të drejtohen pranë drejtorive të shkollave përkatëse ose të ndjekin njoftimet në faqen zyrtare të Bashkisë Vorë.

